



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 25 (827981)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 qershor 2026



QPR, HAPI I PARË DREJT UNIFORMËS

faqe 6



SHQIPËRIA RIKONFIRMON MBËSHTETJEN PËR UKRAINËN NË TAKIMIN E 35-TË TË GRUPIT TË KONTAKTIT PËR MBROJTJEN

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, mori pjesë në Takimin e 35-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, i zhvilluar në Bruksel, ku u diskutua koordinimi i mëtejshëm i mbështetjes për Ukrainën dhe zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë euroatlantike. Gjatë takimit, ministri Nufi rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë në mbështetje të Ukrainës, në përputhje të plotë me vlerat dhe objektivat...

faqe 3



SHQIPËRIA NË TRYEZËN E BASHKËPUNIMIT RAJONAL TË MBROJTJES NË KUADËR TË SEDM

Në Tbilisi, Gjeorgji, u zhvillua takimi i zëvendëshefave të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve pjesëmarrëse në Iniciativën e Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM), ku Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u përfaqësuan nga Zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm, gjenerale brigade Razije Mehmeti. Takimi u kryesua nga kryetari i SEDM-së dhe Ambasadori i Greqisë...

faqe 4



ARMA E TANKEVE: 1.292 MJETE TË BLINDUARA DHE NJË HISTORI GATISHMËRIE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Arma që mbajti mbrojtjen mbi gjurmë të blinduar. Kolonel Budjon Arapi: Arma e Tankeve nuk ishte vetëm teknikë luftarake, por një shkollë disipline, profesionalizmi dhe përgjegjësie. Në historinë e zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës...

faqe 8

Në Tbilisi, Gjeorgji, u zhvillua takimi i zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve pjesëmarrëse në **Iniciativën e Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM)**, ku Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u përfaqësuan nga **Zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm, gjenerale brigade Razije Mehmeti**.

Takimi u kryesua nga kryetari i SEDM-së dhe Ambasadori i Greqisë, me pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë ushtarakë nga vendet anëtare të kësaj iniciative, përfshirë përfaqësues nga Forcat e Armatosura të Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Greqisë, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Turqisë.

Në këtë forum morën pjesë gjithashtu komandanti i **Brigadës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore – SEE-BRIG**, përfaqësues të **Qendrës Rajonale për Bashkëpunim në Sigurinë e Vendit (RACVIAC)** dhe të **Qendrës për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Evropën Juglindore dhe Lindore (RCC)**.

Punimet e takimit u përqendruan në vlerësimin e progresit të arritur në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, si dhe në ecurinë e iniciativave të ndërmarra pas takimit të mëparshëm të këtij forumi, zhvilluar në Republikën e Bullgarisë gjatë vitit 2025.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit ushtarakë paraqitën qëndrimet dhe vlerësimet kombëtare lidhur me projektet e propozuara dhe drejtimit e ardhshme të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes. Në fokus ishte forcimi i koordinimit ndërmjet vendeve pjesëmarrëse dhe zhvillimi i kapaciteteve të përbashkëta për përballimin e sfidave të sigurisë.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua procesit të zhvendosjes së **Shtabit të Përgjithshëm të Brigadës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore – SEEBRIG**, nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Republikën e Turqisë. Ky proces përbën një nga objektivat kryesore të SEDM për vitin 2026 dhe synon forcimin e mëtejshëm të strukturës shumëkombëshe dhe rritjen e efektivitetit të saj operacional.

Pjesëmarrësit rikonfirmuan angazhimin e tyre për vijim



Shqipëria në tryezën e bashkëpunimit rajonal të mbrojtjes në kuadër të SEDM

Gjenerale brigade Razije Mehmeti përfaqëson FARSH-në në takimin e zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme në Tbilisi



min e bashkëpunimit të ngushtë, shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e veprimeve në kuadër të SEDM-së, si një mekanizëm i rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Evropës Juglindore.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë nivel të lartë të bashkëpunimit ushtarak rajonal dëshmon rolin aktiv të Forcave të Armatosura në nismat shumëkombëshe dhe angazhimin e vazhdueshëm për forcimin e partneriteteve të sigurisë.

Takimi i ardhshëm i zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të SEDM-së është parashikuar të zhvillohet në vitin 2027, në Republikën e Serbisë.

Kursi Bazë drejt Profesionalizmit Ushtarak: Forcimi i Gjeneratës së Re të Ushtarit Shqiptar

Në Regjimentin e Këmbësores së Veriut (RKV) në Vaun e Dejës dhe në Qendrën Arsimore Profesionale të Ushtarit (QAPU) në Bunavi, vijon me intensitet **Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë**, ku të rinj dhe të reja që kanë zgjedhur t'i shërbejnë vendit nën uniformën ushtarake po hedhin hapat e parë drejt profesionit të ushtarit.

Prej rreth gjashtë javësh, kursantët po përvetësojnë njohuri, aftësi dhe vlera themelore ushtarake, të cilat përbëjnë bazën e formimit profesional dhe etik të ushtarit të së ardhmes.

Përmes disiplinës së rreptë, përgatitjes fizike dhe edukimit ushtarak, ata po zhvillohen gradualisht në ushtarë profesionistë, të aftë dhe të gatshëm për t'i shërbyer Shqipërisë me dinjitet, përgjegjësi dhe përkushtim.

Energjia, motivimi dhe vendosmëria e kursantëve vlerësohen si një garanci e fortë për të ardhmen e Forcave të Armatosura dhe një burim krenarie për Forcën Tokësore.



Shqipëria rikonfirmon mbështetjen për Ukrainën në Takimin e 35-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, mori pjesë në Takimin e 35-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, i zhvilluar në Bruksel, ku u diskutua koordinimi i mëtejshëm i mbështetjes për Ukrainën dhe zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë euroatlantike.

Gjatë takimit, ministri Nufi rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë në mbështetje të Ukrainës, në përputhje të plotë me vlerat dhe objektivat e NATO-s, duke theksuar qëndrimin e palëkundur të vendit tonë në krah të aleatëve.

“Shqipëria mbetet e palëkundur në qëndrimin e saj përkrah Ukrainës, duke vijuar të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta të aleatëve për mbrojtjen e lirisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai nënvizoi gjithashtu se që nga fillimi i agresionit rus, Shqipëria ka qëndruar krah popullit ukrainas, duke mbështetur përpjekjet ndërkombëtare për mbrojtjen e lirisë dhe sovranitetit të Ukrainës.

Takimi në Bruksel mbledhi ministrat e mbrojtjes të vendeve aleate dhe partnere, me qëllim forcimin e koordinimit dhe vijimin e mbështetjes së përbashkët për Ukrainën në kushtet e zhvillimeve aktuale të sigurisë në Evropë.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë certifikon kursantët e gjuhëve të dyta

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilloi sot ceremoninë e certifikimit të kursantëve që përfunduan me sukses kurset e gjuhëve të dyta pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja.

Në fjalën e tij, Shefi i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, z. Bledar Vrapi, falënderoi kursantët për angazhimin e treguar, stafin mësimdhënës për përkushtimin dhe profesionalizmin, si dhe drejtuesit e Kolegjit për mbështetjen në zhvillimin normal të procesit mësimor.

Nga ana e tij, Shefi i Shtabit të Kolegjit, kolonel Arian Osmani, vlerësoi punën e stafit akademik dhe mbështetës, si dhe përkushtimin e kursantëve në përmbjlljen me sukses të programit mësimor. Ai theksoi rëndësinë e njohjes së gjuhëve të huaja si një vlerë e shtuar në karrierën ushtarake dhe civile.

Procesi mësimor është zhvilluar sipas një programi të detajuar dhe të strukturuar, me metodika bashkëkohore dhe në përputhje me standardet përkatëse të trajnimit.

Në përfundim të kurseve u zhvillua edhe testi **STANAG 6001**, i cili vlerëson katër aftësitë gjuhësore: dëgjimin, leximin, shkrimin dhe folurin.

Kursantët, pjesë e personelit civil dhe ushtarak të Forcave të Armatosura, përfunduan me sukses kurse në gjuhët italiane, frënge, greke, serbe dhe turke.



Forca Ajrore në mbështetje të “Mburoja e Arbrit 2026”, sigurim ajror dhe monitorim operacional i marshimit të forcave

Në kuadër të stërvitjes “**Mburoja e Arbrit 2026**”, Forca Ajrore vijon të japë kontributin e saj në mbështetje të operacioneve të Forcave Tokësore, duke garantuar ndërveprueshmëri, gatishmëri dhe mbështetje të pandërprerë për realizimin me sukses të misionit.

Gjatë aktivitetit stërvitor, Forca Ajrore monitoroi dhe siguroi nga ajri marshimin e **Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë** drejt zonës së stërvitjes, duke angazhuar kapacitete ajrore si helikopterin “**Cougar**” dhe sistemin ajror pa pilot “**Bayraktar TB2**”. Përmes zbulimit dhe vëzhgimit të itinerarit të lëvizjes, monitorimit në kohë reale të kolonës së mjeteve dhe identifikimit të situatave të simuluar gjatë marshimit, mjetet ajrore siguruan informacion të vazhdueshëm operacional për strukturat komanduese në terren.

Ky angazhim kontribuoi në zhvillimin e sigurt, efektiv dhe të koordinuar të aktivitetit, duke dëshmuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet komponentëve të Forcave të Armatosura dhe rritjen e kapaciteteve të ndërveprimit në operacione të përbashkëta. Forca Ajrore vijon të mbetet një faktor i rëndësishëm në mbështetje të misionëve të Forcave Tokësore, duke garantuar aftësi të avancuara monitorimi, zbulimi dhe reagimi në çdo angazhim operacional.





AFA dhe AADF bashkojnë kapacitetet për zhvillimin akademik, inovacionin dhe integrimin me rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë

Partneritet i ri për kërkimin shkencor dhe ndërkombëtarizimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua një takim i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet Komandantit/Rektorit të AFA-së, **gjeneralmajor Ferdinand Dima** dhe përfaqësuesve të **Albanian-American Development Foundation (AADF)**, të kryesuar nga CEO **Martin Mata** dhe **Aleksandër Sarapuli**, së bashku me ekipet përkatëse të të dy institucioneve.

Takimi shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të bashkëpunimit akademik dhe zhvillimit të kërkimit shkencor, duke u konkretizuar me finalizimin e nënshkrimit të dy marrëveshjeve të rëndësishme: programit **“Research Expertise from the Academic Diaspora” (READ)** dhe programit **“Boosting Research and Integrating Diaspora for Education Growth” (BRIDGE)**.

Këto iniciativa përfaqësojnë një mundësi të re për Akademinë e Forcave të Armatosura që të jetë pjesë aktive e rrjetit të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, të cilat përfitojnë mbështetje në fushat e kërkimit shkencor, inovacionit dhe zhvillimit akademik.

Përmes këtyre programeve synohet krijimi i urave të reja bashkëpunimi me ekspertizën akademike shqiptare në diasporë, duke sjellë përvojë ndërkombëtare, dije bashkëkohore dhe mundësi të reja për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të institucionit.

Gjatë takimit u vlerësua rëndësia e partneriteteve



strategjike në rritjen e cilësisë së arsimit ushtarak dhe në përgatitjen e një brezi të ri profesionistësh, të aftë për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë dhe zhvillimeve bashkëkohore.

Akademia e Forcave të Armatosura vijon të angazhohet në zgjerimin e bashkëpunimeve me institucione vendase dhe ndërkombëtare, duke e konsideruar kërkimin

shkencor, inovacionin dhe ndërkombëtarizimin si elementë themelorë të modernizimit institucional.

Ky bashkëpunim i ri me AADF përbën një tjetër hap drejt konsolidimit të rolit të AFA-së si një institucion modern i arsimit të lartë, i orientuar drejt standardeve ndërkombëtare dhe i integruar në rrjetet e zhvillimit akademik e profesional.

Shqipëria vijon kontributin në operacionin e NATO-s “Sea Guardian”, për sigurinë detare në Mesdhe

Bashkëpunimi në kuadër të NATO-s vijon të mbetet një element i rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Mesdheut. Shqipëria po vijon të japë kontribut aktiv krah aleatëve në operacionin ndërkombëtar **“Sea Guardian”**, duke mbështetur përpjekjet e përbashkëta për garantimin e sigurisë detare.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion synon forcimin e ndërveprueshmërisë me vendet aleate, shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.

Përmes angazhimit në misionet ndërkombëtare të NATO-s, Shqipëria vijon të dëshmojë përkushtimin e saj ndaj sigurisë kolektive dhe përgjegjësisë të marra si vend anëtar i Aleancës.

Operacioni **“Sea Guardian”** përfaqëson një nga angazhimet e rëndësishme të NATO-s në fushën e sigurisë detare, duke kontribuar në monitorimin e hapësirave detare, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet aleatëve dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt në Mesdhe.



Nga misioni ushtarak te shërbimi publik: Batalioni i Xhenios ndërton urën e re në Shkodër

Ushtria pranë komunitetit: Batalioni i Xhenios ndërton urën e re në Plan të Shkodrës

Kompania e Urave e Batalionit të Xhenios ka përfunduar ndërtimin e një ure metalike të tipit “Bailey”, me gjatësi 12 metra, në njësinë administrative Plan, bashkia Shkodër. Kjo ndërhyrje u realizua me qëllim përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe krijimin e një lidhjeje më të sigurt ndërmjet fshatrave të zonës, duke lehtësuar lëvizjen e banorëve dhe aksesin e tyre në shërbimet bazë.

Ndërtimi i urës përbën një kontribut të drejtpërdrejtë të Forcave të Armatosura në mbështetje të komunitetit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, veçanërisht në zonat ku infrastruktura kërkon ndërhyrje të specializuara. Përmes kapaciteteve të saj inxhinierike, Batalioni i Xhenios vijon të kontribuojë në realizimin e misioneve në ndihmë të komunitetit, duke dëshmuar gatishmërinë dhe profesionalizmin e personelit ushtarak edhe përtej detyrave të mbrojtjes.



Ekipet EOD të Batalionit të Xhenios në mision për garantimin e sigurisë së komunitetit

Kompania EOD e Batalionit të Xhenios vijon angazhimin e saj për identifikimin dhe pastrimin e sipërfaqeve nga municionet e rrezikshme, duke kontribuar drejtpërdrejt në garantimin e sigurisë së qytetarëve.

Ekipet e specializuara EOD janë dislokuar në bashkitë **Himarë** dhe **Malësi e Madhe**, ku kanë realizuar operacione për identifikimin, vlerësimin dhe largimin e municioneve luftarake të gjetura në këto zona.

Përmes procedurave të specializuara dhe respektimit të standardeve të sigurisë, efektivet e EOD kanë eliminuar rrezikun që paraqesin municionet e pashpërthyer, duke mbrojtur jetën e banorëve dhe pronën e tyre.

Misioni i ekipeve EOD kërkon profesionalizëm të lartë, përgatitje të vazhdueshme dhe përgjegjësi maksimale, pasi çdo ndërhyrje realizohet në kushte të veçanta dhe me prioritet absolut sigurinë.

Batalioni i Xhenios vijon të përmbushë me përkushtim misionet e tij, jo vetëm në mbështetje të Forcave të Armatosura, por edhe në shërbim të drejtpërdrejtë të komunitetit dhe mbrojtjes së qytetarëve.



Forca Detare zhvillon stërvitje të përbashkët në Adriatik me grupin e gatshëm të NATO-s SNMCMG2

Anijet e Forcës Detare të Republikës së Shqipërisë zhvilluan një stërvitje të përbashkët në Detin Adriatik me anijet e **Grupit të Dytë të Gatshëm të Minaheqësve të NATO-s (SNMCMG2)**.

Gjatë aktivitetit stërvitor u realizuan skenarë të ndryshëm operacionalë, të cilët përfshinë manovrimet detare, komunikim taktik ndërmjet ekuipazheve, si dhe operacione furnizimi në det (RAS – Replenishment at Sea).

Këto aktivitete stërvitore synojnë rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave pjesëmarrëse, forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të gatishmërisë operationale në përputhje me standardet e Aleancës.

Pjesëmarrja në stërvitje të përbashkëta me strukturat detare të NATO-s dëshmon angazhimin e Forcës Detare shqiptare për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe kontributin aktiv në sigurinë detare rajonale dhe euroatlantike.





19 VITE NË SHËRBBIM TË UNIFORMMËS

Qendra e Personel Rekrutimit, porta ku nisin rrugëtimet e brezave të rinj të Forcave të Armatosura

NGA NJË APLIKIM TEK NJË MISION

Kolonel Fadil Ciroku: QPR ndërton kapitalin njerëzor të ushtrisë shqiptare

Në një periudhë kur siguria, mbrojtja dhe përgatitja e burimeve njerëzore marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe, Qendra e Personel Rekrutimit vijon të mbetet një nga strukturat kyçe në ndërtimin e së ardhmes së Forcave të Armatosura. Përmes një procesi të vazhdueshëm rekrutimi, përzgjedhjeje dhe zhvillimi profesional, kjo qendër ka qenë ndër vite pika e parë e kontaktit për mijëra qytetarë që kanë zgjedhur rrugën e uniformës ushtarake.

Për lexuesin e gazetës “Ushtria”, komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku, sjell një panoramë të plotë mbi misionin dhe transformimin e kësaj strukture gjatë 19 viteve të aktivitetit të saj. Ai flet për proceset moderne të rekrutimit, për sfidat e ndërtimit të një force të përgatitur, për rikthimin e komponentit rezervist, si dhe për rolin që ka sot QPR-ja në krijimin e kapaciteteve njerëzore të nevojshme për Forcat e Armatosura.

Në rrëfimin e tij, kolonel Ciroku ndalet tek ndryshimi i mentalitetit dhe i kërkesave që shoqërojnë karrierën ushtarake në kohët moderne, ku krahas disiplinës dhe përkushtimit, kërkohen edhe dije, profesionalizëm dhe specialitete të reja.

Nga ushtarët aktivë te oficerët e rinj, nga studentët në akademitë ndërkombëtare te rezervistët që do të përbëjnë një kapacitet shtesë për mbrojtjen kombëtare, çdo proces nis nga një derë: Qendra e Personel Rekrutimit.

Një histori institucionale, por mbi të gjitha një histori njerëzish, që kanë zgjedhur të shërbejnë dhe të mbajnë mbi supe përgjegjësinë e uniformës

Nga dosjet fizike tek transformimi digjital, historia e një strukture që ndërtoi kapitalin njerëzor të Forcave të Armatosura

Rezervistët, brezi i ri i kapaciteteve mbrojtëse, një forcë shtesë për sigurinë kombëtare

Pas çdo rekrutimi nuk ka vetëm një emër në listë,



Komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku

por një histori jete, një betim dhe një mision

22 qershor 2007 – 22 qershor 2026

Në kalendar janë vetëm nëntëmbëdhjetë vite. Por për një institucion që merret me njerëzit, me zgjedhjet e tyre dhe me rrugëtimin drejt uniformës ushtarake, këto vite maten ndryshe: me mijëra aplikime, me mijëra dosje, me breza të rinjsh që kanë kaluar nëpër dyert e një qendre që për shumë

prej tyre ka qenë kontakti i parë me Forcat e Armatosura.

Qendra e Personel Rekrutimit nuk ka qenë thjesht një zyrë ku plotësohen dokumente. Ajo ka qenë pika ku një dëshirë personale është kthyer në një profesion, ku një ëndërr e një të riu është kthyer në një mision dhe ku fjala “uniformë” ka marrë kuptimin e përgjegjësisë.

Në një kohë kur siguria ndërkombëtare ka ndryshuar



dhe sfidat janë bërë më komplekse, roli i burimeve njerëzore është bërë më vendimtar se kurrë. Ushtria nuk ndërtohet vetëm me pajisje dhe teknologji; ajo ndërtohet me njerëz të përgatitur, me karakter, disiplinë dhe përkushtim. Dhe pikërisht këtu qëndron misioni i QPR-së.

Një derë që hapet për një karrierë

Çdo vit, të rinj e të reja trokasin në këtë derë me një pyetje të thjeshtë: **“A mund të bëhem pjesë e Forcave të Armatosura?”**.

Pas kësaj pyetjeje fillon një proces i gjatë vlerësimi: kriteret fizike, shëndetësore, profesionale dhe etike. Nuk është thjesht një përzgjedhje kandidatësh, por një kërkim i njerëzve që mund të mbajnë mbi supe përgjegjësi të mëdha.

QPR administron rekrutimin e ushtarëve aktivë, përzgjedhjen e kandidatëve për studime ushtarake brenda dhe jashtë vendit, përgatitjen e brezit të ri të oficerëve, si dhe programet për pilotë dhe specialitete të ndryshme. Në bashkëpunim me akademitë ushtarake të vendeve aleate, të rinjtë shqiptarë kanë mundësinë të ndjekin studime në institucione prestigjioze ndërkombëtare. Disa prej tyre tashmë janë pjesë e akademive më të njohura ushtarake në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera partnere.

Rezervisti, një kapacitet i ri për mbrojtjen

Një kapitull i rëndësishëm i së ardhmes së Forcave të Armatosura është rikthimi i komponentit rezervist.

Komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku, e shpjegon këtë si një domosdoshmëri të kohës moderne.

Sipas tij, rezervisti nuk është thjesht një forcë rezervë në kuptimin klasik, por një kapacitet shtesë që i bashkohet ushtrisë aktive në rast nevojë. “Rezervisti do të krijojë një forcë shtesë, një kapacitet shtesë që do të plotësojë komponentin aktiv, jo vetëm me numra, por edhe me aftësi”, - thekson komandanti.

Në këtë komponent mund të përfshihen jo vetëm ish-



ushtarakë, por edhe profesionistë civilë me aftësi të veçanta: mjekë, inxhinierë, specialistë të teknologjisë së informacionit, logjistikës apo fusha të tjera që janë të rëndësishme për mbrojtjen moderne.

Bota e sotme ka treguar se konfliktet dhe krizat mund të zgjasin më shumë nga sa parashikohet. Për këtë arsye, shumë vende të NATO-s e konsiderojnë rezervën një pjesë të rëndësishme të arkitekturës së sigurisë.

Nga dosjet në letër tek ushtria digjitale

Një nga ndryshimet më të mëdha të këtyre 19 viteve është transformimi teknologjik. Nga një sistem i mbështetur kryesisht në dokumentacion fizik, QPR-ja është shndërruar në një strukturë moderne që përdor teknologjinë për të ofruar shërbime më të shpejta dhe më transparente.

Mbi 1 milion kartonë të evidencës së Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak janë dixhitalizuar, ndërsa qytetarët tashmë mund të marrin shërbime elektronike përmes platformës e-Albania.

Vetëm në vitin 2025, sektori i rezervës ka administruar mbi 43 mijë shërbime, ku pjesa më e madhe është realizuar online.

Pas këtyre shifrave fshihet një ndryshim i rëndësishëm: qytetari nuk është më i detyruar të përballët me procedura të gjata, por ka një akses më të drejtpërdrejtë në shërbimet që lidhen me historinë e tij ushtarake.



Historia e njerëzve pas statistikave

Një raport nuk mund të matet vetëm me numra. Pas çdo dosjeje është një njeri. Një i ri që vesh uniformën për herë të parë. Një student që largohet për të ndjekur akademinë jashtë vendit. Një ushtarak që rikthehet si rezervist. Një ish-ushtarak që kërkon shërbimin administrativ pas viteve të karrierës...

Për shumë prej tyre, dita më e veçantë nuk është dita e

aplikimit, por dita e betimit. Aty ndryshon gjithçka. Uniforma nuk është më vetëm një veshje. Ajo bëhet simbol i përgjegjësisë, i përkatësisë dhe i një zgjedhjeje personale.

Një ushtri që kërkon cilësi

Vitet e fundit kanë sjellë edhe një rritje të interesit për karrierën ushtarake Sipas të dhënave të QPR-së, është rritur cilësia e kandidatëve dhe interesi për studime ushtarake. Femrat gjithashtu kanë një pjesëmarrje gjithnjë e më të dukshme në proceset e rekrutimit, veçanërisht në programet për oficerë. Forcat e Armatosura po kërkojnë jo vetëm numër, por profesionistë: juristë, financiarë, inxhinierë, specialistë IT, mjekë dhe profile të tjera që i përgjigjen ushtrisë moderne.

Misioni vazhdon....

Sot Qendra e Personel Rekrutimit nuk feston vetëm një përvjetor. Ajo feston një rol. Një rol që lidhet drejtpërdrejt me të ardhmen e Forcave të Armatosura dhe me njerëzit që do të mbajnë uniformën nesër.

Nga viti 2007 deri në vitin 2026, kjo qendër ka qenë porta hyrëse e mijëra shqiptarëve drejt një rruge të veçantë: rrugës së shërbimit.

Dhe ajo portë vazhdon të jetë e hapur. Sepse çdo brez ka nevojë për njerëz që zgjedhin të shërbejnë.

QPR në shifra:

- **19 vite aktivitet**
- **Mijëra të rinj të orientuar drejt karrierës ushtarake**
- **Mbi 1 134 000 evidenca të dixhitalizuara**
- **Mbi 43 000 shërbime të administruara vetëm gjatë vitit 2025**
- **Rekrutim për ushtarë aktivë, studentë ushtarakë, pilotë dhe rezervistë**



Komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit shpreh mirënjohjen për kontributin ndër vite

Përmes shtypit ushtarak, komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku, shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin e tij për të gjithë drejtuesit, komandat dhe institucionet që kanë kontribuar ndër vite në zhvillimin, konsolidimin dhe modernizimin e kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura. Në këtë 19-vjetor të krijimit të QPR-së, kolonel Ciroku vlerëson rolin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për mbështetjen, vizionin dhe orientimin institucional që kanë ndikuar në përmbushjen me sukses të misionit të kësaj qendre. Një falënderim i veçantë i drejtohet të gjithë personelit të Qendrës së Personel Rekrutimit, të kaluar dhe aktual, të cilët me profesionalizëm, përgjegjësi dhe përkushtim kanë kontribuar çdo ditë në ndërtimin e burimeve njerëzore të Forcave të Armatosura.



Sipas kolonel Cirokut, pas çdo procedure rekrutimi, çdo dokumenti të administruar dhe çdo procesi të realizuar qëndron puna e njerëzve që kanë besuar në misionin e kësaj strukture.

“Për 19 vite, Qendra e Personel Rekrutimit nuk ka rekrutuar vetëm personel; ajo ka ndërtuar besim, ka formuar breza ushtarakësh dhe ka hapur rrugën për ata që zgjedhin të shërbejnë dhe të mbajnë mbi supe përgjegjësinë e mbrojtjes së atdheut”, – shprehet kolonel Fadil Ciroku.



Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

Arma që mbajti mbrojtjen mbi gjurmë të blinduar

Kolonel Budjon Arapi: Arma e Tankeve nuk ishte vetëm teknikë luftarake, por një shkollë disipline, profesionalizmi dhe përgjegjësie

Në historinë e zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Arma e Tankeve përfaqëson një kapitull të veçantë të organizimit, përgatitjes dhe ndërtimit të kapaciteteve tokësore.

Nga themelet e hedhura, më 24 qershor 1928, me dekret të Mbretit Ahmet Zogu, deri në krijimin e strukturave të mirëfillta tankiste pas vitit 1946, kjo armë kaloi nëpër disa etapa zhvillimi: krijimi, konsolidimi, zgjerimi maksimal dhe më pas ristrukturimi në kushtet e ndryshimeve të mëdha pas viteve '90.

Në kulmin e saj, në fund të viteve '80, Arma e Tankeve dispononte rreth 1.292 tanke dhe mjete të blinduara, të organizuara në brigada dhe njësi të mekanizuara. Pas kësaj force qëndronte një sistem i tërë: njerëz të trajnuar, mirëmbajtje teknike, struktura komanduese dhe një kulturë e fortë gatishmërie.

Për të sjellë këtë histori për lexuesin e gazetës "Ushtria", kemi zhvilluar një bisedë me ish-komandantin e Armës së Tankeve, kolonel Budjon Arapi.

Kolonel, si do ta përkufizonit historinë e Armës së Tankeve në Forcat e Armatosura Shqiptare?

Arma e Tankeve është një histori zhvillimi ushtarak që lidhet me përpjekjen për të ndërtuar një kapacitet të fuqishëm tokësor, të përshtatur me kërkesat e kohës.

Nuk bëhet fjalë vetëm për mjete luftarake, por për një sistem të plotë organizativ. Një forcë tankiste kërkon njerëz të përgatitur, struktura komanduese, mekanikë, teknikë, logjistikë dhe një disiplinë të lartë pune.

Fillimet lidhen me vitin 1928, por zhvillimi real filloi pas Luftës së Dytë Botërore, kur u krijuan njësitë e para të organizuara.

Cili ishte momenti që shënoi lindjen e vërtetë të strukturës tankiste shqiptare?

Më 1 prill 1946, krijohet Kompania e Parë e Tankeve. Ky ishte momenti kur tanku kaloi nga një koncept në një element konkret të organizimit ushtarak.

Në atë periudhë u krijuan bazat e para të përgatitjes së ekuipazheve dhe të përdorimit të teknikës së blinduar.

Fillimisht u përdorën mjete të trashëguara dhe të kapura, më pas u kalua në pajisje sovjetike dhe më vonë kineze.

Ky proces kërkoi kohë, sepse krahas marrjes së teknikës duhej ndërtuar edhe kultura profesionale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Në vitin 1948 krijohet Regjimenti "Vojo Kushi". Çfarë rëndësie pati kjo strukturë?

Krijimi i Regjimentit "Vojo Kushi" ishte një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit.

Nga njësi të vogla dhe në fazë fillestare, kaluam në një formacion më të organizuar, me komandë, strukturë dhe detyra të përcaktuara.

Ky ishte një tregues se Arma e Tankeve po merrte një rol të rëndësishëm në organizimin e forcave tokësore.

Si ndryshoi situata me krijimin e Brigadës së Parë të

ARMA E TANKEVE: 1.292 MJETE TË BLINDUARA DHE NJË HISTORI GATISHMËRIE

Nga krijimi i strukturave të para deri te kulmi operacional i forcës së blinduar shqiptare



Tankeve në vitin 1963?

Krijimi i brigadës shënoi kalimin në një nivel më të lartë organizimi.

Një brigadë nuk është thjesht më shumë tanke. Ajo është një strukturë komplekse ku bashkëveprojnë komandimi, zbulimi, mbështetja teknike, furnizimi dhe përgatitja e personelit.

Në këtë periudhë u rrit edhe niveli i trajnimit dhe standardizimit të njësisë.

Vitet '70 konsiderohen si periudha e zgjerimit më të madh të Armës së Tankeve. Si ishte realiteti i asaj kohe?

Ishte periudha e zhvillimit maksimal strukturor. Kishte rreth 10 brigada tankiste dhe një numër të madh batalionesh të mekanizuara.

Tanku konsiderohej elementi kryesor i goditjes tokësore dhe vepronte në bashkëpunim me këmbësorinë dhe

strukturat e tjera.

Por ajo që e mbante këtë sistem ishte gatishmëria. Nuk mjaftonte të kishe tanke; duhej që ato të ishin funksionale dhe personeli të ishte i trajnuar.

Çfarë kërkohej nga një ekuipazh tanku?

Kërkohej shumë disiplinë dhe përgjegjësi. Brenda një tanku çdo anëtar i ekuipazhit kishte një detyrë të qartë. Bashkëpunimi ishte vendimtar.

Komandanti, drejtuesi, qitësi dhe pjesëtarët e tjerë duhej të funksiononin si një trup i vetëm. Përgatitja nuk ishte vetëm teknike. Ishte edhe psikologjike, sepse shërbimi në një mjet të blinduar kërkon qetësi, vendimmarrje dhe besim te njëri-tjetri.

Në fund të viteve '80 flitet për rreth 1.292 tanke dhe mjete të blinduara. Si menaxhohej një kapacitet i tillë?

Ishte një sistem i madh. Kishte struktura për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e teknikës. Mjetet mbaheshin në kushte të kontrolluara dhe kishte një proces të vazhdueshëm kontrolli. Çdo teknikë luftarake ka vlerë vetëm nëse mbahet në gjendje pune. Prandaj mirëmbajtja ishte një pjesë shumë e rëndësishme e gatishmërisë.

Cili ishte roli i tankeve në doktrinën e mbrojtjes së asaj periudhe?

Tanku shihej si forcë kryesore e veprimit tokësor.

Detyrat lidheshin me mbrojtjen e territorit, kundërgoditjen dhe mbështetjen e njësisë të tjera.

Përdorimi i tyre kërkonte koordinim të plotë me këmbësorinë dhe armët mbështetëse.

Pas viteve '90 filloi reduktimi i strukturave. Si e përjetoi Arma e Tankeve këtë transformim?

Ishte një periudhë ndryshimesh të mëdha. Ndryshoi situata ndërkombëtare, ndryshuan konceptet e sigurisë dhe natyrisht ndryshuan edhe strukturat ushtarake. Nga një forcë e madhe numerike u kalua drejt një force më të vogël dhe më fleksibël. Ishte një proces i vështirë, sepse pas çdo



strukture ushtarake janë njerëzit, përvoja dhe tradita.

Çfarë kujtoni më shumë nga vitet tuaja në komandimin e njësisë tankiste?

Kujtoj njerëzit. Mjetet mund të ndryshojnë, teknologjia përparon, por vlera kryesore janë ushtarakët.

Kujtoj disiplinën, përkushtimin dhe seriozitetin me të cilin njerëzit kryenin detyrën.

Arma e Tankeve ishte një shkollë ku mësoje përgjegjësinë dhe punën në grup.

Çfarë mesazhi do t'u jepnit brezave të rinj që studiojnë historinë ushtarake?

Duhet ta njohin historinë jo vetëm për të kujtuar të kaluarën, por për të kuptuar se si ndërtohen kapacitetet ushtarake.

Një ushtri zhvillohet me njerëz të përgatitur, me profesionalizëm dhe me aftësi për t'u përshtatur me kohën.

Historia e Armës së Tankeve është pjesë e historisë së Forcave të Armatosura dhe e atyre mjera ushtarakëve që shërbyen në të.





Forcat Tokësore, “Mburoja e Arbrit” e profesionalizmit dhe gatishmërisë operacionale të Ushtrisë Shqiptare

Në terrenin stërvitor, aty ku sfidohen aftësitë, përgatitja dhe vendimmarrja nën presion, Forcat Tokësore të Ushtrisë Shqiptare vijnë të dëshmojnë se profesionalizmi dhe përkushtimi janë shtyllat kryesore të një force moderne, të aftë për të përmbushur misionin e saj në çdo situatë.

Stërvitja “Mburoja e Arbrit 26/05” është një tjetër dëshmi e këtij angazhimi të vazhdueshëm dhe e përpjekjeve për konsolidimin e kapaciteteve operacionale sipas standardeve më të larta të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Forcat Tokësore përbëjnë një nga komponentët më të rëndësishëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ato janë struktura që mbajnë mbi vete përgjegjësinë e përgatitjes dhe zhvillimit të operacioneve tokësore, duke garantuar gatishmëri, reagim të shpejtë dhe aftësi për t'u përballur me sfida të ndryshme të sigurisë.

Në këtë kuadër, **Grup Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë** vijon procesin e rritjes së aftësive profesionale përmes stërvitjeve intensive, ku ndërthuren përvoja praktike, disiplinë ushtarake dhe zbatimi i procedurave taktike bashkëkohore.

Stërvitja “Mburoja e Arbrit 26/05” përfaqëson një fazë të rëndësishme në rrugëtimin e përgatitjes së trupave. Përmes skenarëve realistë taktikë, personeli ushtarak u përball me situata që kërkonin koordinim të lartë, reagim të shpejtë, komunikim efektiv dhe marrje vendimesh në kushte të ngjashme me ato të operacioneve reale.

Këto aktivitete nuk janë vetëm ushtrime rutinë. Ato janë pjesë e një procesi të vazhdueshëm ndërtimi dhe zhvillimi të një force moderne, ku çdo ushtarak përgatitet për të përmbushur detyrën me profesionalizëm dhe përgjegjësi.



Shqipërisë për të kontribuar në kuadër të angazhimeve të saj euroatlantike.

Forca Tokësore, garanci për siguri dhe stabilitet

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare, Forcat Tokësore kanë pasur gjithmonë një rol të rëndësishëm. Nga mbrojtja e territorit kombëtar deri te pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare, ato kanë dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim. Sot, në një realitet të ri sigurie, ku sfidat janë më komplekse dhe kërkojnë reagim të shpejtë, modernizimi dhe përgatitja e vazhdueshme janë domosdoshmëri.

Stërvitja “Mburoja e Arbrit 26/05” tregon se Ushtria

Shqiptare ecën në drejtimin e duhur, duke ndërtuar një forcë më të aftë, më të përgatitur dhe më të ndërveprueshme.

Forcat Tokësore mbeten një shtyllë e rëndësishme e mbrojtjes së vendit dhe një faktor i besueshëm në garantimin e siguri. Përkushtimi i ushtarakëve, disiplina dhe profesionalizmi i tyre janë dëshmi se Ushtria Shqiptare është e gatshme të përmbushë misionin e saj me dinjitet dhe përgjegjësi.

“Mburoja e Arbrit” nuk është vetëm një stërvitje, është një dëshmi e forcës, përgatitjes dhe vullnetit për të qenë gjithmonë të gatshëm.



Përgatitja sipas standardeve të NATO-s

Një nga objektivat kryesorë të këtyre stërvitjeve është harmonizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Forcave të Armatosura me standardet e NATO-s. Përvoja e fituar në vite dhe pjesëmarrja në misione ndërkombëtare kanë ndikuar në rritjen e nivelit profesional të trupave shqiptare.

Zbatimi i procedurave standarde, planifikimi operacional dhe koordinimi ndërmjet strukturave, janë elementë që garantojnë një forcë më të efektshme dhe më të ndërveprueshme me aleatët.

Në fushën e operacioneve moderne, suksesi nuk përcaktohet vetëm nga pajisjet dhe teknologjia, por mbi të gjitha nga aftësia e njerëzve që i përdorin ato. Për këtë arsye, investimi më i madh mbetet gjithmonë te përgatitja e ushtarakut, te formimi i tij profesional dhe te krijimi i një kulture të fortë disipline.

Ushtaraku, elementi kryesor i fuqisë operacionale

Pamjet nga stërvitja “Mburoja e Arbrit 26/05” përcjellin një mesazh të qartë: pas çdo kapaciteti ushtarak qëndron njeriu. Ushtari i Forcave Tokësore është produkt i një procesi të gjatë trajnimit, ku ndërthuren përgatitja fizike, aftësitë taktike, vendosmëria dhe përgjegjësia për misionin.

Terreni, kushtet atmosferike dhe kompleksiteti i skenarëve stërvitorë krijojnë një mjedis ku testohet jo vetëm aftësia individuale, por edhe forca e ekipit. Një njësi e suksesshme është ajo që vepron si një trup i vetëm, ku çdo pjesëtar kupton rolin e tij dhe kontribuon për realizimin e objektivit të përbashkët.

Drejt certifikimit “I aftë për mision”

Procesi drejt certifikimit “I aftë për mision” është një nga synimet më të rëndësishme të strukturave ushtarake shqiptare. Ky standard kërkon përgatitje të vazhdueshme, vlerësim të aftësive dhe përmbushje të kërkesave të përcaktuara operacionale.

Stërvitje të tilla janë momente ku maten progresi, identifikohen fushat për përmirësim dhe forcohet besimi i ndërsjellë brenda njësisë. Çdo aktivitet i realizuar në terren është një investim në sigurinë kombëtare dhe në aftësinë e



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu



Gjeneral Brigade Razie Mehmeti



Gjeneral Brigade Vehbie Kuti

GJENERALET SHQIPTARE NË ELITËN USHTARAKE: LIDERSHIP, DINJITET DHE FUQIA E PROFESIONALIZMIT PA GJINI

Gruaja në uniformë - Nga sfida e paragjykimit tek dinjiteti i komandës

Ka ndryshime që nuk maten vetëm me ligje, reforma apo statistika. Ka ndryshime që maten me guximin e njerëzve që hapin rrugën përpara. Një prej këtyre ndryshimeve të mëdha në shoqërinë shqiptare është edhe rrugëtimi i gruas drejt barazisë së plotë në çdo fushë të jetës, përfshirë edhe një nga institucionet më të rëndësishme të shtetit: **Forcat e Armatosura**.

Për shumë kohë, uniforma ushtarake është parë si një simbol i lidhur kryesisht me burrin. Lufta, komanda, vendimmarrja dhe drejtimi ushtarak shpesh janë perceptuar si fusha ku gruaja duhej të qëndronte në distancë.

Por historia ka treguar të kundërtën.

Gruaja nuk ka qenë kurrë më pak e aftë për të udhëhequr. Ajo thjesht është përballur me më shumë barriera për të dëshmuar aftësitë e saj.

Sot, gruaja në uniformë është një realitet i fuqishëm. Ajo nuk është më vetëm pjesë mbështetëse e strukturave të mbrojtjes. Ajo është oficerë. Ajo është drejtuese. Ajo është komandante. Ajo është pjesë e vendimmarrjes strategjike.

Dhe mbi të gjitha, ajo është dëshmi se profesionalizmi, përkushtimi dhe aftësia nuk kanë gjini.

“Uniforma nuk mat gjininë e atij që e vesh, por peshën e betimit që mban mbi supe. Ajo nuk kërkon dallime, por përgjegjësi; nuk kërkon zëra të lartë, por njerëz të aftë për të udhëhequr, mbrojtur dhe shërbyer”.

Të veshësh uniformën ushtarake do të thotë të pranosh një mision. Do të thotë disiplinë. Do të thotë sakrificë. Do të thotë të jesh gati për vendin tënd në çdo kohë.

Gruaja që zgjedh karrierën ushtarake përballat jo vetëm me sfidat profesionale, por edhe me paragjykimet që kanë ekzistuar ndër vite.

Ajo duhet të dëshmojë jo një herë, por shumë herë, se vendi i saj është aty ku aftësia dhe përkushtimi e çojnë.

Por çdo arritje e saj ka një vlerë më të madhe se suksesi personal.

Ajo ndryshon perceptimin e shoqërisë. Ajo bëhet shembull për vajzat e reja që shohin se edhe fusha të tilla si mbrojtja dhe siguria janë pjesë e së ardhmes së tyre.

Gratë gjenerale, simbol i një epoke të re në Forcat e Armatosura

Një nga dëshmitë më të forta të këtij transformimi është arritja e grave shqiptare në nivelet më të larta të karrierës ushtarake.

Sot, emra si **Gjeneralmajor Manushaqe Shehu**, **Gjeneral Brigade Vehbie Kuti**, **Gjeneral Brigade Razie Mehmeti**, përfaqësojnë jo vetëm suksese individuale, por një kapitull të rëndësishëm në historinë e pjesëmarrjes së



“Uniforma nuk mat gjininë e atij që e vesh, por peshën e betimit që mban mbi supe. Ajo nuk kërkon dallime, por përgjegjësi; nuk kërkon zëra të lartë, por njerëz të aftë për të udhëhequr, mbrojtur dhe shërbyer”. Të veshësh uniformën ushtarake do të thotë të pranosh një mision. Do të thotë disiplinë. Do të thotë sakrificë. Do të thotë të jesh gati për vendin tënd në çdo kohë.

grave në Forcat e Armatosura.

Këto gra janë shembuj të një rruge të ndërtuar me vite punë, përkushtim dhe profesionalizëm. Arritja e gradave madhore ushtarake nuk është një dhuratë.

Ajo kërkon përgatitje të vazhdueshme, aftësi drejtuese, përgjegjësi dhe përballje me sfida të mëdha.

Një gjenerale në uniformën shqiptare është më shumë se një figurë komanduese. Ajo është një mesazh. Mesazhi se lidershpi nuk përcaktohet nga gjinia. Mesazhi se autoriteti fitohet me punë.

Mesazhi se gruaja shqiptare mund të jetë në çdo nivel të shërbimit ndaj vendit.

Pas uniformës është një grua me shumë role

Por pas çdo ushtarakeje ekziston edhe një histori njerëzore. Ajo është nënë.

Është bijë.

Është bashkëshorte.

Është pjesë e një familjeje.

Dhe shpesh duhet të balancojë përgjegjësi që kërkojnë shumë forcë.

Karriera ushtarake nuk është një rrugë e lehtë.

Ajo kërkon sakrificë.

Kërkon orë të gjata pune.

Kërkon përballje me situata të vështira.

Por pikërisht këtu qëndron madhështia e gruas në uniformë: ajo tregon se forca nuk është mungesa e vështirësive, por aftësia për t'i përballuar ato.

Nga modeli individual tek ndryshimi shoqëror

Kur një vajzë sheh një grua në gradën e gjeneralit, ajo nuk sheh vetëm një person që ka arritur sukses.

Ajo sheh një mundësi.

Sheh një rrugë.

Sheh një të ardhme ku ëndrrat nuk kufizohen nga bindjet e vjetra.

Modelet kanë rëndësi.

Një shoqëri ndryshon kur vajzat e saj rriten duke

besuar se mund të jenë gjithçka që aftësitë dhe puna i lejojnë të bëhen.

Gruaja në Forcat e Armatosura, krenari dhe përgjegjësi kombëtare

Sot Forcat e Armatosura shqiptare janë pjesë e një realiteti të ri ku kontributi i grave vlerësohet jo si përjashtim, por si pjesë e natyrshme e profesionalizmit ushtarak.

Gratë në uniformë kanë treguar se mund të jenë të forta pa humbur vlerat njerëzore, të vendosura pa humbur ndjeshmërinë, të afta për të komanduar dhe njëkohësisht për të frymëzuar.

Ato nuk kërkojnë trajtim të veçantë.

Ato kërkojnë të maten me të njëjtin standard: me punën, dijen dhe përkushtimin.

Dhe pikërisht kjo është drejtësia më e madhe.

Sepse një ushtri moderne është ajo që njeh vlerën e çdo ushtaraku të saj. Një shtet i fortë është ai që përdor gjithë potencialin e njerëzve të tij.

Një shoqëri e zhvilluar është ajo që nuk pyet më: **“Çfarë mund të bëjë një grua?”**

Por pyet: **“Sa larg mund të shkojë ajo?”**

Sepse përgjigjja tashmë është dhënë nga gratë shqiptare në uniformë.

Ato kanë shkuar deri në komandë.

Deri në përgjegjësi.

Deri në majat më të larta të shërbimit ushtarak.

Të jesh grua do të thotë të mbash mbi supe jetën, përgjegjësinë dhe ëndrrën njëkohësisht; të jesh forcë pa zhurmë, vendosmëri pa arrogancë dhe dritë që nuk fliket as në sfidat më të vështira.

Shtypi ushtarak ka qenë dhe do të mbetet zëri i tyre: dëshmitar i sakrificës, pasqyrë e profesionalizmit dhe kujtesë e përhershme e shërbimit ndaj atdheut. Jeta në Forcat e Armatosura mbetet boshti që mban dhe drejton botën e disiplinës, përgjegjësisë dhe nderit, aty ku formohet karakteri dhe forcohet shteti.

Pesha e Fjalës dhe Vlera e Heshtjes në Shoqërinë Moderne

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Pesha e fjalës dhe heshtja si vlerë e humbur

Në një kohë kur fjala qarkullon më shpejt se mendimi dhe reagimi shpesh i paraprin arsyes, shprehja “sikur njerëzit ta dinin peshën e fjalëve, do t'i jepnin më shumë vlerë heshtjes”, tingëllon më shumë si një diagnozë shoqërore sesa si një thënie filozofike. Ajo prek thelbin e mënyrës si komunikojmë sot: të nxituar, të fragmentuar, shpesh të pakontrolluar dhe gjithnjë e më pak të përgjegjshëm ndaj ndikimit që fjalët lënë pas.

Fjala si akt përgjegjësie

Fjala nuk është thjesht mjet komunikimi. Ajo është akt. Në momentin që shqiptohet, fjala del nga sfera e mendimit dhe hyn në botën e veprimit. Ajo mund të ndërtojë ose të rrënojë, të pajtojë ose të ndajë, të shërojë ose të plagosë. Historia e njerëzimit është e mbushur me shembuj ku fjala ka qenë pikënisja e ndryshimeve të mëdha shoqërore, por edhe e konflikteve të thella.

Në jetën e përditshme, kjo peshë shpesh nënvlerësohet. Një koment i thjeshtë mund të ndikojë në dinjitetin e një njeriu; një fjali e nxituar mund të shkatërrojë besimin mes dy individëve; një deklaratë e pamenduar mund të ndezë tensione të panevojshme. Në këtë kuptim, fjala nuk është kurrë neutrale. Ajo mban gjithmonë një ngarkesë emocionale dhe sociale.

Shpejtësia e kohës dhe humbja e reflektimit

Shoqëria bashkëkohore karakterizohet nga shpejtësia. Informacioni qarkullon në kohë reale, reagimet kërkohen menjëherë dhe heshtja shpesh interpretohet si mungesë qëndrimi. Në këtë klimë, reflektimi mbi fjalën është zbehur.

Rrjetet sociale kanë krijuar një hapësirë ku fjala prodhohet në seri, shpesh pa filtra. Ajo që dikur kërkonte kohë për t'u menduar dhe formuluar, sot publikohet brenda sekondash. Në këtë proces, humbet një element thelbësor: pesha e mendimit para se ai të bëhet fjalë.

Kjo nuk do të thotë se komunikimi modern është domosdoshmërisht negativ, por se ai kërkon një vetëdije më të lartë për përgjegjësinë që mbart.

Heshtja si formë e inteligjencës emocionale

Heshtja shpesh keqkuptohet si mungesë reagimi, si pasivitet ose si tërheqje. Në realitet, ajo është një formë e sofistikuar e komunikimit. Heshtja mund të jetë reflektim, vëzhgim, analizë dhe maturi.

Në shumë raste, heshtja ka më shumë peshë se fjala. Ajo krijon hapësirë për mendim të thelluar dhe shmang konfliktet e panevojshme. Në një debat të nxehtë, heshtja mund të jetë akt vetëkontrolli. Në një situatë të ndjeshme, ajo mund të jetë shenjë respekti. Në marrëdhënie njerëzore, ajo mund të jetë mënyra më e pastër për të ruajtur dinjitetin e të dy palëve. Në këtë kuptim, heshtja nuk është boshllëk, por mbushje e mendimit me përmbajtje.

Fjala që lëndon dhe fjala që shëron

Fjala ka ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin që individët kanë për veten dhe për të tjerët. Një fjali negative e përsëritur mund të krijojë pasiguri afatgjatë, ndërsa një fjalë mbështetëse mund të ndërtojë vetëbesim. Në familje, në shkollë, në vendin e punës apo në hapësirën publike, mënyra se si flasim përcakton cilësinë e marrëdhënieve. Fjalët e ashpra shpesh lënë gjurmë më të thella se veprimet fizike, sepse ato prekin identitetin dhe dinjitetin e individit.

Në të kundërt, fjala e menduar mirë, e matur dhe e sinqertë mund të ketë efekt terapeutik. Ajo mund të pajtojë, të qetësojë dhe të ndërtojë ura komunikimi atje ku duket se ka vetëm ndarje.



Kriza e dëgjimit në shoqërinë moderne

Një nga paradokset më të mëdha të kohës sonë është se flasim më shumë, por dëgjojmë më pak. Komunikimi është bërë shpesh monolog i ndërprerë, ku secili pret radhën për të folur, pa dëgjuar realisht tjetrin. Kjo krizë e dëgjimit e bën fjalën më të lehtë, por më pak të vlefshme. Kur fjala nuk dëgjohej, ajo humbet peshën e saj. Kur nuk ka reflektim mbi atë që thuhet, komunikimi kthehet në zhurmë.

Heshtja e ndërgjegjshme mund të shihet si akt dëgjimi. Ajo i jep hapësirë tjetrit dhe krijon mundësi për kuptim të vërtetë.

Etika e të folurit

Të flasësh nuk është thjesht aftësi, por edhe përgjegjësi etike. Çdo fjalë e thënë në hapësirën publike ose private mbart një dimension moral. Ajo mund të ndikojë në mënyrën se si perceptohet një person, një grup apo një ide. Prandaj, etika e të folurit kërkon tri elemente thelbësore: mendim para fjalës, maturi në formulim dhe vetëdije për pasojat. Pa këto elemente, fjala rrezikon të kthehet në instrument dëmtimi.

Në këtë kuptim, heshtja nuk është thjesht alternativë ndaj fjalës, por pjesë e saj. Ajo është hapësira ku fjala merr formë të përgjegjshme.

Heshtja në kulturë dhe filozofi

Në tradita të ndryshme kulturore dhe filozofike, heshtja është konsideruar si virtyt. Ajo është lidhur me mençurinë, meditimin dhe vetëkontrollin. Filozofët e lashtë e shihnin heshtjen si kusht për të arritur njohjen e vetvetes.

Në kulturën moderne, ky dimension shpesh është zbehur, por nuk është zhdukur. Në realitet, nevoja për heshtje është më e madhe se kurrë, pikërisht për shkak të mbingarkesës me fjalë dhe informacion. Heshtja krijon distancë nga kaosi i jashtëm dhe mundëson qartësi të brendshme.

Fjala në jetën publike

Në diskursin publik, fjala ka ndikim të drejtpërdrejtë në klimën shoqërore. Politika, media dhe komunikimi institucional varen nga mënyra se si përdoret gjuha. Një gjuhë e polarizuar prodhon ndarje; një gjuhë e matur mund të krijojë stabilitet.

Në këtë kontekst, përgjegjësia e fjalës është edhe më e madhe, sepse ajo nuk prek vetëm individin, por shoqërinë në tërësi. Çdo deklaratë publike është pjesë e një ekosistemi komunikimi që ndikon në perceptimin kolektiv.

Rikthimi te pesha e fjalës

Shprehja se njerëzit do t'i jepnin më shumë vlerë heshtjes nëse do ta kuptonin peshën e fjalës nuk është thjesht një reflektim poetik. Ajo është një thirrje për vetëdije. ***Të kuptosh peshën e fjalës do të thotë të kuptosh se çdo fjalë ka pasojë. Do të thotë të pranosh se komunikimi nuk është vetëm e drejtë për të folur, por edhe detyrim për të menduar. Dhe do të thotë të njohësh heshtjen jo si mungesë, por si zgjedhje të vetëdijshme.***

Në një botë që flet pa pushim, ndoshta akti më i rrallë dhe më i vlefshëm është të dish kur të heshtësh.



BRANKO KADIA



PERLAT REXHEPI



JORDAN MISJA

22 QERSHOR 1942, LUFTA E TRE HERONJVE TË SHKODRËS, NJË EPOPE E QËNDRESËS ANTIFASHISTE

Një nga faqet më të ndritura të rezistencës antifashiste shqiptare u shkrua, më 22 qershor 1942, në qytetin e Shkodrës. Në një kohë kur Shqipëria ndodhej nën pushtimin fashist italian, tre të rinj antifashistë Perlat Rexhepi, Branko Kadia dhe Jordan Misja u përballën me forcat e shumta të pushtuesit, duke e kthyer sakrificën e tyre në një simbol të guximit, idealit dhe dashurisë për lirinë.

Viti 1942 ishte një periudhë e rëndë për Shqipërinë. Pas pushtimit italian të 7 prillit 1939, vendi jetonte nën administrimin e pushtuesit fashist. Forcat italiane përpiqeshin të vendosnin kontrollin e plotë politik, ushtarak dhe ekonomik, ndërsa në mbarë vendin po rritej kundërshtimi ndaj pushtimit. Në qytete dhe zona të ndryshme po organizoheshin grupet e rezistencës antifashiste, të cilat kërkonin çlirimin e vendit.

Në këtë atmosferë përballjeje, Shkodra – një qytet me tradita të forta patriotike dhe kulturore – u bë një nga qendrat më aktive të rezistencës. Pikërisht këtu, më 22 qershor 1942, ndodhi ngjarja që do të mbetej në histori si “Lufta e Tre Heronjve të Shkodrës”.

Tre të rinjtë që sfiduan pushtuesin

Perlat Rexhepi, Branko Kadia dhe Jordan Misja ishin tre të rinj të angazhuar në lëvizjen antifashiste. Ata i përkisnin një brezi që në kushtet e pushtimit zgjodhi të mos pajtohej me nënshtrimin dhe terrorin fashist. Veprimtaria e tyre ishte pjesë e përpjekjeve të rezistencës për të goditur strukturat e pushtimit dhe për të ngritur ndërgjegjen e popullit kundër fashizmit.

Mëngjesin e 22 qershorit 1942, forcat italiane të pushtimit, të shoqëruara nga karabinierë dhe milicë, rrethuan shtëpinë në rrugën “Firej” në Shkodër, ku ndodheshin tre të rinjtë. Pushtuesit kërkuan dorëzimin e tyre, por përgjigjja ishte qëndresa.

Ajo që pasoi ishte një përballje e pabarabartë. Përballë tre luftëtarëve qëndronin forca të shumta të armatosura, me epërsi të madhe në njerëz dhe mjete luftarake. Megjithatë, Perlat Rexhepi, Branko Kadia dhe Jordan Misja vendosën të mos dorëzoheshin.

Një betejë që zgjati me orë

Rrethimi u shndërrua në një luftim të ashpër. Nga jashtë sulmonin forcat fashiste, ndërsa nga brenda tre të rinjtë vazhdonin rezistencën. Shtëpia u kthye në një pikë përballjeje ku u përplasën forca të pabarabarta, por me një ndryshim të madh: njëra palë luftonte për pushtim, ndërsa pala tjetër për liri.



Perlat Rexhepi, Branko Kadia dhe Jordan Misja ishin tre të rinj të angazhuar në lëvizjen antifashiste. Ata i përkisnin një brezi që në kushtet e pushtimit zgjodhi të mos pajtohej me nënshtrimin dhe terrorin fashist. Veprimtaria e tyre ishte pjesë e përpjekjeve të rezistencës për të goditur strukturat e pushtimit dhe për të ngritur ndërgjegjen e popullit kundër fashizmit.

Në fund të kësaj përballjeje, tre heronjtë ranë duke luftuar. Ata nuk u dorëzuan dhe emrat e tyre mbetën të lidhur përgjithmonë me një nga aktet më të njohura të rezistencës antifashiste shqiptare.

Perlat Rexhepi, simbol i vendosmërisë

Perlat Rexhepi u bë një nga figurat më të njohura të rezistencës antifashiste në Shkodër. I ri në moshë, por me një bindje të fortë për lirinë e vendit, ai u kthye në simbol të guximit dhe të sakrificës. Qëndrimi i tij gjatë rrethimit tregoi vendosmërinë e një brezi që e shihte luftën kundër pushtimit si detyrë historike.

Branko Kadia, luftëtar i lirisë

Branko Kadia ishte një tjetër nga tre të rinjtë që zgjodhën përballjen me pushtuesin. Emri i tij u lidh me atë ditë të jashtëzakonshme në Shkodër, ku ai tregoi trimëri dhe përkushtim ndaj idealit antifashist. Sakrifika e tij u bë pjesë e kujtesës së qytetit dhe të historisë së luftës për çlirim.

Jordan Misja, dëshmori i rezistencës

Jordan Misja, një figurë e njohur e rezistencës antifashiste, u dallua për vendosmërinë dhe angazhimin e tij. Rënia e tij në betejën e 22 qershorit 1942 e vendosi emrin e tij mes dëshmorëve që u përkujtuan për kontributin në luftën kundër pushtimit.

Jehona e një sakrifice

Lajmi i betejës së tre të rinjve u përhap në të gjithë vendin dhe pati ndikim të madh në moralin e rezistencës. Ngjarja tregoi se edhe përballë një fuqie ushtarake më të madhe, vullneti për liri mund të shfaqej në forma të jashtëzakonshme. Kujtimi i tyre u përjetësua edhe përmes artit. Menjëherë pas ngjarjes, Kolë Jakova shkroi dhe kompozoi këngën “Tre heronjtë e Shkodrës”, e cila u bë një nga krijimet më të njohura kushtuar kësaj ngjarjeje. Përmes vargjeve dhe melodisë, kënga ruajti kujtimin e tre të rinjve dhe e përcolli atë brez pas brezi.

Trashëgimia historike

22 qershori 1942, mbetet një datë e rëndësishme në historinë e rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lufta e Tre Heronjve të Shkodrës nuk ishte vetëm një betejë me armë, por një simbol i qëndresës morale dhe i sakrificës për një ideal. Për shtypin ushtarak, kjo ngjarje përfaqëson një kapitull të rëndësishëm të historisë ushtarake dhe patriotike të Shqipërisë. Ajo kujton një brez të rinjsh që në një periudhë të vështirë zgjodhën të përballeshin me pushtimin dhe të vendosnin interesin e atdheut mbi jetën e tyre.

Perlat Rexhepi, Branko Kadia dhe Jordan Misja mbeten në kujtesën kombëtare si tre emra që lidhen me guximin, sakrificën dhe luftën për liri.

22 qershori i vitit 1942 mbetet dëshmi se historia e një kombi shkruhet edhe nga ata që, në momentet më të vështira, zgjedhin të qëndrojnë.

Nga banka e Shkollës “Skënderbej” te poezia, publicistika dhe historia e mbrojtjes kundërajrore shqiptare

Në historinë e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” kanë kaluar mijëra djem që më pas u bënë komandantë, gjeneralë, studiues, shkencëtarë, diplomatë, sportistë e artistë. Ndër emrat që kanë lënë gjurmë si në Forcat e Armatosura ashtu edhe në publicistikën ushtarake, një vend të veçantë zë koloneli në rezervë **Avni Skënderi**, një oficer karriere, studiues, poet dhe publicist, i cili për më shumë se tri dekada e gjysmë i shërbeu me përkushtim mbrojtjes së hapësirës ajrore të Shqipërisë.

Ai përfaqëson një brez ushtarakësh që profesionin nuk e panë vetëm si detyrë, por si mision ndaj atdheut. Krahës uniformës, ai mbajti gjithmonë pranë edhe lapsin, duke e kthyer përvojën e tij ushtarake dhe njerëzore në libra, poezi dhe analiza historike.

Fillimet në Mallakastër

Avni Skënderi lindi, më 4 tetor 1950, në fshatin Ninësh të Mallakastrës, një krahinë që i ka dhënë vendit shumë personalitete në fushën e arsimit, kulturës dhe ushtrisë.

Arsimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën shtatëvjeçare në Fratar. Talenti dhe rezultatet e mira në mësimet i hapën dyert e një prej institucioneve më prestigjioze të kohës, **Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”**, ku studioi gjatë viteve **1962–1966**.

Pikërisht aty u formësuan karakteri, disiplina dhe dashuria për atdheun, vlera që do ta shoqëronin gjatë gjithë jetës.

Vetë ai e konsideron këtë periudhë si themelin mbi të cilin u ndërtua e gjithë karriera e tij.

Një karrierë 35-vjeçare në mbrojtjen kundërajrore

Pas përfundimit të shkollës “Skënderbej”, Avni Skënderi ndoqi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në specialitetin e Artilerisë Kundërajrore.

Më pas kreu edhe Akademinë e Mbrojtjes, si dhe studime pasuniversitare në fushën e artit ushtarak, filozofisë dhe gjuhës angleze, duke dëshmuar një përkushtim të vazhdueshëm ndaj formimit profesional.

Për **35 vjet**, ai shërbeu në repartet e mbrojtjes kundërajrore, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Komandën e Forcave Ajrore.

Gjatë kësaj periudhe mbajti një sërë detyrash me përgjegjësi të lartë:

- **komandant baterie;**
- **komandant grupi kundërajror;**
- **shef operativ regjimenti;**
- **shef shtabi regjimenti;**
- **shef i degës së stërvitjes;**
- **shef i degës operative në Komandën e Mbrojtjes Kundërajrore;**
- **shef i përgatitjes së shtabeve në Komandën e Forcave Ajrore.**

Avni Skënderi ishte një oficer korrekt, i përgatitur dhe kërkues ndaj vetes, por njëherazi edhe komunikues e frymëzues për vartësit.

Në shtator të vitit 2004 ai doli në rezervë, duke mbyllur një karrierë të gjatë e të suksesshme në Forcat e Armatosura.

Studiues i historisë së mbrojtjes ajrore

Pas daljes në rezervë, Avni Skënderi nuk u shkëput nga jeta ushtarake. Ai vazhdoi të kontribuojë nëpërmjet studimeve dhe botimeve.

Ndër veprat më të rëndësishme profesionale përmenden:

- **“Mbrojtja Kundërajrore e Shqipërisë”**, një studim i rëndësishëm mbi organizimin dhe zhvillimin historik të kësaj arme;
- **“Në roje të Qiellit”**, kushtuar historisë së mbrojtjes ajrore shqiptare;
- **“Komandanti Maqo Zoto”**, monografi për një nga figurat më të njohura të ushtrisë shqiptare;
- **“1997 – Ditët e tmerrit në një ditar”**, një dëshmi autentike mbi periudhën më të vështirë të shtetit shqiptar.

Këto libra përbëjnë sot një burim me vlerë për studiuesit e historisë ushtarake shqiptare.

Nga qielli i mbrojtjes te universi i poezisë

Përveç profesionit të oficerit, Avni Skënderi ka kultivuar prej dekadash edhe poezinë.

Ai është autor i vëllimeve poetike:



AVNI SKËNDERI – PENA QË VAZHDOI MISIONIN E UNIFORMËS

Ish-skënderbegasi, oficeri i karrierës, studiuesi i mbrojtjes kundërajrore, poeti dhe publicisti ushtarak, që për më shumë se 35 vjet i shërbeu Forcave të Armatosura dhe vijon të kontribuojë me veprën e tij në historinë dhe kulturën ushtarake shqiptare.

- **“Më shumë dritë”**
- **“Ditari i shpirtit tim”**

Në poezinë e tij ndërthuren dashuria për vendlindjen, kujtimet e rinisë, shërbimi ushtarak, familja dhe ndjenja e fortë patriotike.

Gjuha është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë dhe plot emocion.

Shumë prej krijimeve të tij janë botuar në shtypin ushtarak dhe në media të ndryshme shqiptare.

“Shkollë legjendë”, një himn për Skënderbegasit

Ndër krijimet më të njohura të tij është poema “Shkollë legjendë”, kushtuar Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Në këtë poezi, autori rikthen me mall vitet e rinisë, edukimin patriotik dhe lidhjen shpirtërore me shkollën që e formoi. Poezia nuk është thjesht një kujtim nostalgjik. Ajo është një dëshmi historike dhe emocionale për rolin që luajti kjo shkollë në edukimin e brezave të oficerëve shqiptarë. Në vargjet e saj gjejmë krenarinë për uniformën, respektin për mësuesit, kujtimin e shokëve dhe dhimbjen për mbylljen e këtij institucioni.

Vargjet: “Jam skënderbegas, si atëherë...”

dhe “Emri skënderbegas të ndrisë mbi varrin tim...”

janë bërë ndër më të cituarat nga ish-skënderbegasit në aktivitetet përkujtimore.

Publicist i angazhuar

Përveç poezisë, Avni Skënderi ka qenë për shumë vite bashkëpunëtor i shtypit ushtarak.

Artikujt e tij trajtojnë historinë e Forcave të Armatosura, figurat e shquara ushtarake, edukimin patriotik dhe problematikat e mbrojtjes kombëtare.

Ai shkruan me gjuhë të qartë, të mbështetur në dokumente dhe në përvojën personale.

Një jetë e përkushtuar familjes dhe shoqërisë

Avni Skënderi edhe pas daljes në rezervë mbetet aktiv në jetën shoqërore të ish-ushtarakëve dhe të komunitetit të skënderbegasve.

Në takimet përkujtimore ai është ndër zërat më aktivë për ruajtjen e historisë dhe traditave të Shkollës “Skënderbej”.

Një emër që mbetet në historinë e Skënderbegasve

Historia e Avni Skënderit është historia e një brezi oficerësh që i shërbyen vendit me profesionalizëm, përkushtim dhe ndershmëri. Ai mbetet një figurë që bashkon në mënyrë harmonike ushtarakun, studiuesin dhe poetin.

Në librat e tij jeton historia e mbrojtjes kundërajrore shqiptare; në poezitë e tij jeton kujtesa e brezit të skënderbegasve. Pikërisht për këtë arsye, emri i Avni Skënderit zë një vend të merituar në panteonin e ish-nxënësve të Shkollës Legjendare “Skënderbej”, duke dëshmuar se uniforma dhe pena mund të ecin së bashku në shërbim të atdheut.

Në figurën e tij ndërthuren oficeri profesionist, studiuesi serioz dhe poeti që nuk reshti kurrë së kënduari për atdheun, shokët, shkollën dhe idealet që e shoqëruan gjatë gjithë jetës.

BIOTEKNOLOGJIA DHE GJENETIKA

A po krijohet “ushtari i përmirësuar”?

Nga laboratorët e shkencës tek fushat e betejës, dilema e shekullit XXI është: a po shndërrohet bioteknologjia në armën e re të luftës?

Shkenca që po ndryshon kufijtë e njeriut

Në dekadat e fundit, bioteknologjia ka kaluar nga një fushë e kufizuar në laboratorë universitarë në një industri globale me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin, ushqimin dhe sigurinë e njerëzimit. CRISPR-Cas9, një teknikë e revolucionit gjenetik, ka bërë të mundur “prerjen” dhe “ngjitjen” e segmenteve të ADN-së me saktësi kirurgjikale. Ajo që dikur dukej si fantashkencë, sot është realitet: mundësia për të korrigjuar defekte gjenetike, për të rritur rezistencën ndaj sëmundjeve dhe për të optimizuar funksionet biologjike.

Por ky progres nuk ka mbetur vetëm në fushën e mjekësisë. Raporte të ndryshme sugjerojnë se disa laboratorë ushtarakë po eksperimentojnë me aplikime të bioteknologjisë përtej kurimit – drejt krijimit të individëve me aftësi të jashtëzakonshme.

Nga kurimi tek optimizimi i trupit

Në mjekësi, bioteknologjia është një revolucion i mirëpritur. Ajo ka potencialin të eliminojë sëmundje të trashëguara, të parandalojë epidemitë dhe të zgjasë jetëgjatësinë. Por kur e njëjta teknologji përdoret për të rritur muskujt, për të përmirësuar shikimin apo për të shtuar rezistencën ndaj dhimbjes, ajo kalon nga kurimi tek optimizimi i trupit për performancë. Ky hap i vogël, por i rrezikshëm, është arsyeja pse shumë ekspertë paralajmërojnë se kufiri mes shkencës humane dhe shkencës ushtarake po bëhet gjithnjë e më i paqartë.

Strategjitë ushtarake dhe “super-ushtari”

Koncepti i “ushtarit të përmirësuar” nuk është i ri. Që në Luftën e Dytë Botërore, ushtritë përdorën substanca kimike për të rritur vigjilencën dhe rezistencën e trupave. Sot, me bioteknologjinë moderne, ky vizion ka marrë një dimension krejt tjetër.

Një “super-ushtar” i projektuar përmes gjenetikës mund të përfshijë:

- Forcë fizike të shtuar përmes manipulimit të hormoneve dhe gjeneve muskulare.
- Rezistencë ndaj stresit përmes ndërhyrjes në sistemin nervor.
- Shikim të përmirësuar në errësirë përmes modifikimeve të retinës.
- Imunitet më të fortë ndaj sëmundjeve dhe toksinave.
- Kapacitet kognitiv të rritur, duke përdorur teknologji që ndikojnë në kujtesë dhe përqendrim.
- Shërim më të shpejtë nga plagët, falë manipulimit të qelizave staminale.

Në teori, një ushtri e tillë do të ishte më pak e varur nga stërvitja tradicionale dhe më shumë nga inxhinieria biologjike – një transformim i plotë i konceptit të luftëtarit.

Etika dhe dilemat morale


Krijimi i një “super-ushtari” ngre pyetje të mëdha etike:

- A ka të drejtë një individ të zgjedhë jetën e tij, apo do të mbetet i programuar për luftë?
- A është e pranueshme të ndërhysh në gjenet e njeriut për qëllime ushtarake?
- Çfarë ndodh kur teknologjia e tillë bie në duar të gabuara?

Organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe Komiteti i Bioetikës i OKB-së kanë paralajmëruar se përdorimi i bioteknologjisë për qëllime ushtarake mund të shkelë të drejtat themelore të njeriut dhe të hapë rrugën për abuzime të rënda. Për më tepër, krijimi i një individi të “programuar” për luftë mund të shkatërrojë konceptin e lirisë personale.

Rreziku i garës globale

Ashtu si garat bërthamore të shekullit XX, sot po flitet për një garë bioteknologjike. Fuqitë e mëdha mund të ndihen të detyruara të investojnë në “super-ushtarë”



Organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe Komiteti i Bioetikës i OKB-së kanë paralajmëruar se përdorimi i bioteknologjisë për qëllime ushtarake mund të shkelë të drejtat themelore të njeriut dhe të hapë rrugën për abuzime të rënda. Për më tepër, krijimi i një individi të “programuar” për luftë mund të shkatërrojë konceptin e lirisë personale.

për të mos mbetur prapa. Ky skenar do të krijonte një spirale të rrezikshme, ku trupat njerëzorë shihen si projekte teknologjike dhe jo si individë me dinjitet. Historianët paralajmërojnë se një garë e tillë mund të destabilizojë paqen globale, duke e kthyer trupin e njeriut në fushëbetejën e re të teknologjisë.

Shpresa dhe frika e së ardhmes

Nga njëra anë, bioteknologjia ka potencial të jashtëzakonshëm për të shpëtuar jetë: kurimi i sëmundjeve gjenetike, parandalimi i epidemive, rritja e jetëgjatësisë. Nga ana tjetër, përdorimi i saj për qëllime ushtarake mund të

shndërrojë këtë dhuratë të shkencës në një mjet shkatërrimi. Shkencëtarët paralajmërojnë se kufiri mes “përmirësimit” dhe “manipulimit” është shumë i hollë, dhe një hap i gabuar mund të ketë pasoja të pakthyeshme.

Dilema e shekullit XXI

Nëse shekulli XX u shënuar nga bomba atomike, shekulli XXI mund të mbahet mend për “ushtarin e përmirësuar”. Pyetja nuk është më nëse teknologjia e lejon këtë, por nëse shoqëria do ta pranojë. Në fund, dilema mbetet: a do ta përdorim gjenetikën për të shpëtuar njerëzimin, apo për ta shndërruar atë në një instrument lufte?

Alarmi Global: Paralajmërimi i Shkencëtarëve për Vitin 2026

Në historinë e njerëzimit, paralajmërimet e shkencëtarëve shpesh janë parë si zëra të largët, të mbuluar nga zhurma e përditshmërisë. Por sot, një paralajmërim i fuqishëm po ngrihet mbi horizontin e vitit 2026.

Fizikani Heinz von Foerster, i njohur për analizat e tij mbi sistemet komplekse, ka sugjeruar se ky vit mund të përfaqësojë një pikë kritike për shoqërinë globale. Nuk bëhet fjalë për një profeci të pashmangshme, por për një paralajmërim të bazuar në tendencat e dukshme: rritja e popullsisë, kriza ushqimore, urbanizimi i pakontrolluar, shpyllëzimi dhe ndryshimet klimatike.

Ndërsa parashikimi i Von Foerster-it është i bazuar në ekuacione komplekse, të cilat projektojnë rritjen eksponenciale të popullsisë deri në nivele të paqëndrueshme në vitin 2026.

Ky shkrim synon të analizojë faktorët kryesorë, pasojat e mundshme dhe rrugët e veprimit që mund të na ndihmojnë të shmangim një katastrofë globale; është një thirrje për reflektim, por edhe për veprim.

Faktorët Kryesorë të Rrezikut

Rritja e Popullsisë

Popullsia e botës po rritet me ritme të shpejta. Çdo vit, miliona njerëz shtohen në qytete dhe fshatra, duke rritur kërkesën për ushqim, ujë dhe energji. Ky presion mbi burimet natyrore është i paprecedentë. Nëse nuk menaxhohet me kujdes, mund të çojë në mungesa të mëdha dhe konflikte për mbijetesë. Shembuj nga historia tregojnë se kur popullsia rritet më shpejt se kapaciteti i prodhimit, shoqëritë përballen me kriza të thella. Roma e lashtë, për shembull, u përball me vështirësi të mëdha për të ushqyer qytetarët e saj, gjë që kontribuoi në rënien e saj.

Ekonomisti anglez Thomas Robert Malthus, i lindur në vitin 1766, teorizoi se rritja e popullsisë gjithmonë do të tejkalojë furnizimin me ushqim. Ai pohonte se përmirësimi i njerëzimit është i pamundur pa kufizime të rrepta mbi riprodhimin. Përparimet teknologjike në fushën e bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit e kanë përmirësuar situatën që nga koha e Malthusit, por mbipopullimi mbetet ende një shqetësim i madh.

Siguria Ushqimore

Një nga sfidat më të mëdha është ushqimi. Ndryshimet klimatike po ndikojnë në prodhimin bujqësor, duke sjellë thatësira të gjata, përmytje dhe shkatërrim të tokave pjellore. Urbanizimi i pakontrolluar po zvogëlon sipërfaqet e tokës bujqësore, ndërsa kërkesa për ushqim po rritet. Kjo krijon një hendek të rrezikshëm mes nevojës dhe mundësisë. Organizata Botërore e Ushqimit ka paralajmëruar se mungesa e ushqimit mund të bëhet një nga krizat më të mëdha të shekullit XXI.

Urbanizimi dhe Shpyllëzimi

Qytetet po zgjerohen me shpejtësi, shpesh pa planifikim të qëndrueshëm. Shpyllëzimi masiv po shkatërron ekosistemet, duke zhdukur biodiversitetin dhe duke ulur kapacitetin e planetit për të thithur dioksid karboni. Humbja e pyjeve është një plagë e hapur që përkeqëson krizën klimatike. Amazona, e njohur si “mushkëria e planetit”, po humbet mijëra hektarë çdo vit, duke rrezikuar jo vetëm speciet e saj, por edhe ekuilibrin global të klimës.


Ndryshimet Klimatike

Temperaturat ekstreme, stuhitë e fuqishme, përmytjet dhe thatësitrat janë tashmë realitet. Shkencëtarët paralajmërojnë se këto fenomene do të intensifikohen, duke e bërë jetën më të vështirë për miliona njerëz. Ndryshimet klimatike nuk janë më një rrezik i largët, por një krizë e tashme. Raportet e fundit tregojnë se vitet e fundit kanë qenë ndër më të nxehtët të regjistruar ndonjëherë, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta në shëndetin dhe ekonominë globale.

Pasojat e Mundshme

Nëse këto faktorë bashkohen pa ndërhyrje, pasojat mund të jenë dramatike:

- Kriza globale e ushqimit dhe energjisë, ku miliona njerëz do të vuajnë nga uria.
- Konflikte sociale dhe politike, të nxitura nga mungesa e burimeve. Historia na ka treguar se luftërat shpesh kanë lindur nga nevoja për burime.
- Kolaps ekonomik, ku tregjet nuk do të mund të



përballojnë presionin e krizave të njëkohshme.

- Rrezik për shëndetin publik, me shpërthime epidemish të lidhura me kushtet e dobëta të jetesës.

Ky paralajmërim është një kujtesë se edhe civilizimi modern nuk është imun. Teknologjia nuk mund të zgjidhë gjithçka nëse nuk shoqërohet me politika të mençura dhe solidaritet global.

Thirrja për Veprim

Megjithatë, ky paralajmërim nuk është një dënim i pashmangshëm. Ai është një thirrje për veprim.

Politikat e gjelbra: Qeveritë duhet të investojnë në energji të rinovueshme, menaxhim të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtje të biodiversitetit.

Ndërgjegjësimi publik: Shoqëria duhet të kuptojë se çdo veprim i vogël ka ndikim. Konsumi i përgjegjshëm, ulja e mbetjeve dhe mbështetja për nisma mjedisore janë hapa të domosdoshëm.

Roli i individëve: Çdo person mund të kontribuojë, duke ndryshuar zakonet e përditshme, duke zgjedhur produkte të qëndrueshme dhe duke reduktuar ndotjen.

Bashkëpunimi ndërkombëtar: Krizat globale kërkojnë zgjidhje globale. Asnjë vend nuk mund ta përballojë i vetëm. Marrëveshjet ndërkombëtare për klimën dhe mjedisin duhet të respektohen dhe të forcohen.

Mesazhi përfundimtar është i qartë: Ky paralajmërim është një mundësi për të ndryshuar kursin, jo një dënim i pashmangshëm.

Viti 2026 mund të shënojë një pikë kritike, por gjithçka varet nga zgjedhjet që bëjmë sot. Shkencëtarët na kanë dhënë një paralajmërim të qartë. Tani është radha jonë të veprimë. Nëse arrijmë të bashkojmë përpjekjet, të ndryshojmë politikat dhe të ndërgjegjësojmë shoqërinë, mund të shmangim katastrofën dhe të hapim një kapitull të ri për njerëzimin.

Ky shkrim nuk është vetëm një analizë, por një thirrje për reflektim dhe veprim. Historia do të na gjykojë jo për paralajmërimet që morëm, por për veprimet që ndërmorëm.



NJË STREHË PËR FËMIJËT E USHTARAKËVE SHPRESE

Në zemër të Batalionit të Mbështetjes Rajonale në Tufinë, Tiranë, prej vitit 2015 funksionon Qendra e Trajtimit Terapeutik dhe Edukimit për fëmijët e personelit ushtarak me çrregullime të spektrit të autizmit dhe sfida të tjera zhvillimore.

Kjo qendër ofron kujdes të specializuar psikologjik dhe terapeutik, përmes terapive individuale, terapisë ABA, aktiviteteve zhvillimore dhe programeve sociale që ndihmojnë fëmijët të përmirësojnë komunikimin, aftësitë njohëse dhe integrimin në jetën e përditshme.

MOS E PËRBALLONI VETË! KËRKONI MBËSHTETJE!

Nëse jeni pjesë e Forcave të Armatosura dhe përballeni me sfida në zhvillimin e fëmijës suaj, Qendra është e hapur për ju. Përfitoni nga shërbimet profesionale, të specializuara dhe të dedikuara për familjet ushtarake.

NJË MESAZH QË NUK DUHET HARRUAR

Asnjë familje nuk duhet të mbetet vetëm përballë këtyre sfidave. Çdo fëmijë meriton kujdes, vëmendje, zhvillim dhe shpresë për një të ardhme më të mirë.

➔ Çdo fëmijë meriton kujdes, vëmendje, zhvillim dhe shpresë për një të ardhme më të mirë.



Telefon:
+355 67 404 0084



Email:
qkmbm@mod.gov.al